



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 16, date 10/03/2004

**PËR
“MIRATIMIN E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2003
DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2004”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 19, pika 1-8 dhe neni 32 gërma “ç” dhe “dh”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993, “Për buxhetin lokal”, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, ligjit Nr.8379, dt.29/07/1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, ligjit Nr.9165, dt.23/12/2003 “Për buxhetin e shtetit për vitin 2004”, ligjit Nr.7971, dt.26/07/1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin Nr.8767, dt.05/04/2001, neni 8, pika 5, Udhëzimit Nr.1, dt.30/01/2004 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2004”, Udhëzimin e përbashkët midis Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrisë së Financave, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratoje realizimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2003, sipas tabelës Nr.1, Nr.1/1, Nr.1/2, Nr.2, Nr.3, Nr.4 dhe Nr.4/1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Të miratojë detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2004, sipas tabelës Nr.5, Nr.6, Nr.7, Nr.7/1, Nr.7/2, Nr.7/3 dhe Nr.8 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë Tiranë për vitin 2004 në shumën prej 4.698.571,8 mijë lekësh, detajuar si më poshtë:
 - Fondi i mbartur nga viti 2003 1.161.951,8 mijë lekë

- Taksa vendore 2.997.500 mijë lekë
- Të ardhura jotatimore 539.120 mijë lekë

4. Të miratojë përdorimin e të ardhurave për vitin 2004, sipas pikës 3 të këtij Vendimi, si më poshtë:

Fond limit për shpenzime korrente 2.053.036,2 mijë lekë
Fond limit për shpenzime kapitale (investime) 2.645.535,6 mije lekë

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike për të kryer transferimet gjatë vitit buxhetor për shpenzimet e funksioneve të deleguara, pas miratimit nga Ministria e Financave.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Prokurimit Publik dhe të gjithë strukturat e tjera të Bashkisë, Institucionet dhe Ndërmarrjet në varësi të saj.

7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI